



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr.02/_____

Datë: 22.02.2019

Mbështetur në nenin 43 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në bazë të Statutit të Komunës së Malishevës, miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës me datë:31.10.2008 (nr.01/871, datë 12.11.2008) dhe Rregulloren nr.02/175 datë:30.05.2017 për punën e Kuvendit, Komiteteve, dhe Komisioneve të Komunës së Malishevës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës me datë:22/02/2019 ;

T H Ë R R E T

Mbledhjen e -II- (dytë) të rregullt të Kuvendit të Komunës së Malishevës për vitin 2019 të legjislaturës së -VI, e cila do të mbahet ditën e **Enjte** me datë: 28.02.2019 duke filluar nga ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Ftohet z/zj. _____ që të marrë pjesë në këtë mbledhje.

Për këtë mbledhje propozoj këtë,

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e XIII-2018.
2. Emërimi i një anëtari nga zyra e kryetarit të Komunës në Komisionin për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve, si dhe emërtime të reja.
3. Emërimi i një anëtari nga radhët e Nisma Socialdemokrate në Komisionin për iniciimin e procedurave për hartimin e draft-Rregullores për organizmin e Javës së Diasporës.
4. Emërimi i anëtareve në Komisionin për Kompaninë “Ekoregjioni”, njësia në Malishevë.
5. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës nr.02/483 datë:20.11.2018 për lirim nga taksa komunale për leje ndërtimi në Bujqësi, sipas kërkesës së MAPL-së nr.020-1337/6 datë: 24.12.2018.
6. Shqyrtimi i Raportit nr.02/106 datë:21.02.2019 i Komisionit për verifikimin e shërbimeve të varrimit për vitin 2018.
7. Shqyrtimi i shkresës përcjellëse nr.06/401/2019 të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, sipas kërkesës nr.02/23 datë:14.01.2019 të parashtruar nga z.Ibrahim Morina nga fshati Astrazup.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/09 datë:08.01.2019 e parashtruar nga Shoqata e Arsimitarëve pensionist në Komunën e Malishevës.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/492 datë: 26.11.2018 të parashtruar nga Kryqi i Kuq i Kosovës-Dega në Malishevë.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit nr.03/05 datë:12.02.2019 të Punës së Zyrës së Prokurimit Publik për vitin 2019.
11. Shqyrtimi i Raportit nr.02/67 datë: 04.02.2019 të KRU “Hidroregjioni Jugor”, njësia operative në Malishevë.
12. Shqyrtimi i Raportit nr.02/534 datë:12.12.2018 të Komitetit për Komunitete për vitin 2018
13. Shqyrtimi i Raportit nr.02/34 datë:17.01.2019 të Komitetit për Diasporë për vitin 2018.
14. Shqyrtimi i Raportit nr.02/63 datë: 28.01.2019 të Komitetit për Barazi Gjinore për vitin 2018
15. Shqyrtimi i Raportit nr.02/12 datë:10.01.2018 të Komitetit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2018
16. Shqyrtimi i Raportit nr.02/25 datë:14.01.2019 të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2018.
17. Shqyrtimi i Raportit nr.02/59 datë: 24.01.2019 të Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid, Veteranë të Luftës së UÇK-së, si dhe Martirë të Luftës për vitin 2018.
18. Shqyrtimi i Raportit nr.02/57 datë:24.01.2019 të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2018.
19. Shqyrtimi i Raportit nr.02/39 datë:21.01.2019 të Komisionit Komunal të Aksionarëve për vitin 2018.
20. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të punës nr.01/138 datë:08.02.2019 të Këshillit Komunal për Siguri në

Bashkësi për vitin 2019.

21. Inicimi i procedurave për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve.
22. Shqyrtimi i Raportit nr.11/85 datë:12.02.2019 të DKAE-së, për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor 2018/19.
23. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1597 datë:06.11.2018 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për ndërrimin e pronës publike me pronë private për interes publik, me rastin e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në fshatin Panorç, KK.Malishevë.
24. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/188 dat:20.02.2019 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për marrjen e vendimit, sipas kërkesës nr.01/176 datë:14.02.2019 të parashtruar nga kryesia e Lagjes Matoshi-Qytetit të Malishevës, për caktimin e lokacionit për realizmin e projektit të Komunitetit “Ndërtimi i shtëpisë së Komunitetit”.
25. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/201 datë:22.02.2019 të parashtruar nga Kryetari i Komunës për vazhdimin e mandatit të kryetarëve dhe kryesive të fshatrave dhe vendbanimeve tjera, deri në zgjedhjet e reja.
26. Miratimi i dorëheqjes së anëtares znj.Vera Bytyçi nga Komiteti për Barazi Gjinore.
27. Të ndryshme.

Ardhja e juaj është e domosdoshme.
Malishevë, Shkurt 2019

Kryesuesi i Kuvendit
Rrahim Morina
